



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

2020

SHËRBIMET DHE PRODUKTET FINANCIARE

Banka Qendrore e
Republikës së Kosovës dhe
Grupi i Bankës Botërore
me mbështetjen e Qeverisë Zvicerane



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Kjo broshurë është një produkt i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Grupit të Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave (Payment Systems Development Group - PSDG) në Praktikën e Financës, Konkurrencshmërisë dhe Novacionit në Bankën Botërore.

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (State Secretariat of Economic Affairs - SECO) Zvicëran mundësoi financimin për këto materiale në kontekstin e programit të remitancave dhe pagesave.

www.remittanceprices.worldbank.org



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763



Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org

Telephone: +1 202 473-1000

Fotografia e kopertinës nga Spencer Montero

© Grupi i Bankës Botërore, 2020

SHËRBIMET DHE PRODUKTET FINANCIARE


Nëse jeni shtetas rezident i cili merr para nga diaspora dhe keni një llogari të hapur bankare, është e rëndësishme **të familjarizoheni me shërbimet dhe produktet bazë të ofruara në tregun financiar.**



LLOGARITË BANKARE

Përveç llogarive bankare në valuta të huaja të cilat **përdoren për të marrë dhe dërguar shuma parash në valutë të huaj**, ekzistojnë dhe llogari të ndryshme bankare në valutën zyrtare - Euro, të cilat përdoren brenda vendit për pagesa të rregullta (psh. pagat) apo pagesa periodike (psh. honoraret).

Me hapjen e këtyre llogarive në banka komerciale, mund të merrni dhe dërgoni pagesa, në bazë të fondit që dispononi në valutën Euro.



KARTELAT E PAGESAVE

Kartelat e Debitit

Me hapjen e një llogarie bankare në valutë të huaj ose një llogarie rrjedhëse bankare, mund të përdori ***kartela debiti për të përdorur fondet tuaja***, brenda dhe jashtë vendit.

Ju mund të tërhiqni para nga bankomatët (ATM), të paguani për produkte dhe shërbime nëpërmjet terminaleve POS, të kryeni blerje online ose thjesht të kontrolloni gjendjen e llogarisë suaj.

Këshilla:

- ***Përdorni rrjetin e ATM-ve të bankës tuaj*** për të shmangur tarifat shtesë për tërheqje të parave;
- ***mbani PIN-in dhe kartelën tuaj të sigurt*** dhe larg kontaktit me të tjerë;
- ***paguani në valutën e njëjtë sikurse shitësi për të shmangur tarifën e këmbimit të valutës;***
- ***blini vetëm nëpërmjet faqeve zyrtare të webit të cilat kanë “s” në linkun e tyre https://.***



KARTELAT E ELPAGESAVE

Kartelat e Kreditit

Kartelat e kreditit **janë mjete huadhënie ose huamarrje** për pagesa jokesh për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, si dhe për tërheqje kesh pranë ATM-ve. Këto para nuk janë fondet tuaja, ndaj bëni kujdes me tarifat dhe normat e interesit që mund të keni, në varësi të shumës së kredituar si dhe llojit të përdorimit.

Këshillë:

Mbani mend të informoheni për kushtet e përdorimit dhe kostot e përdorimit, **para nënshkrimit të kontratës!**



KREDITË

Kreditë përfaqësojnë **një shumë parash të dhëna borxh prej një institucioni financiar ndaj një klienti. Kjo shumë parashikohet të paguhet brenda një periudhe të caktuar kohore, sipas kushteve të specifikuara dhe me interes të pagueshëm.**

Nisur nga qëllimi për të cilin merren, kreditë mund të jenë me qëllim të përcaktuar ose të pacaktuar; mund të jenë afatshkurtra ose afatgjata; si dhe mund të jenë në valutë vendore ose të huaj.

Kreditë në valutë të huaj në parim përmbajnë një nen për valutën, të cilit duhet t'i kushtojmë rëndësinë e duhur dhe ta kuptojmë mirë, para nënshkrimit të kontratës.



KREDITË

Norma efektive e interesit pasqyron koston e plotë të lidhur me kredinë dhe duhet të përcaktohet qartë në kontratë.

Kjo mundëson krahasimin e drejtpërdrejtë me produktet e tjera të kredisë dhe ndihmon klientët të kuptojnë se sa duhet të paguajnë për kredinë.



KREDITË

Institucioni financiar përpara aprovimit të një kredie, do të vlerësojë aftësinë tuaj paguese si klient, konkretisht mundësinë tuaj për të kryer pagesat e kësteve mujore krahasuar me të ardhurat dhe fondin që dispononi.

Transferet e rregullta hyrëse nga jashtë vendit në llogarinë tuaj bankare mund të vlerësohen pozitivisht nga institucionet financiare përsa i përket aprovimit të kërkesës tuaj për kredi.

Shembull për ndryshimet midis normës nominale dhe efektive të interesit

Ofertë Kredie	Norma Nominale e Interesit	Norma Efektive e Interesit
<i>Institucioni Financiar 1</i>	3,98%	5,92%
<i>Institucioni Financiar 2</i>	4,40%	5,85%
<i>Institucioni Financiar 3</i>	5,96%	6,50%


KURSIMET

Të kursyerit është një shprehje e mirë e cila na mundëson të arrijmë qëllimet tona dhe të menaxhojmë më mirë shpenzimet e paparashikuara. Bankat ofrojnë disa mundësi kursimi, si më poshtë:

- » **Llogari depozitimi me deponime dhe tërheqje**, të palimituara por pa interes ose me interes shumë të ulët,
- » **Llogari standarde kursimi**, pa limit kohor por me limit tërheqjesh, të cilat kanë norma interesi pak më të larta, dhe
- » **Llogari depozitimi me kohë të përcaktuar**, të cilat nuk lejojnë deponime apo tërheqje në këtë afat kohor dhe kanë norma më të larta interesi.

Depozituesit janë të siguruar, për secilën bankë anëtare, deri në shumën e siguruar prej 5,000 Euro, sipas Ligjit për Sigurimin e Depozitave.

Këshillë: Depozitoni para në valutë të huaj në një llogari kursimi, sepse shtetet mund t'i tërheqin nga qarkullimi kartëmonedhat e caktuara, duke e bërë më të vështirë këmbimin e tyre.



BANKINGU ELEKTRONIK DHE TELEFONIK

Bankingu digjital ofron një sërë përparësish për konsumatorin, duke ju ofruar kontakt të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm me llogaritë tuaja bankare, si dhe ***mundësinë për të kryer pagesa dhe transaksione pa pasur nevojë të shkoni në bankë.***

Gjithashtu, nëpërmjet bankngut digjital mund të bëni kërkesa online dhe të ***komunikoni me bankën tuaj 24 orë.***

Krahasuar me shërbimet në degët e bankave, tarifat e e-banking janë përgjithësisht më të ulëta.



KËMBIMI I PARAVE / VALUTAVE

Bankat dhe institucionet e tjera të autorizuara blejnë dhe shesin valuta të huaja. Secila bankë publikon kursin e saj të këmbimit, bazuar në tregun e kursit të këmbimit të valutës së huaj.

Keni parasysh se komisioni i këmbimit për Euron nuk mund të jetë më i lartë se 1%.



URDHËRPAGESAT

Këto instrumente mundësojnë **kryerjen e pagesave mujore direkt nga llogaria juaj bankare drejt palëve të treta**. Koha e lëshimit të urdhërpagesave automatike dhe shuma e pagesave mund të jenë fikse, sipas përcaktimeve nga mbajtësi i llogarisë, ose mund të jenë të ndryshueshme (p.sh. kur kryen pagesat e faturave të shërbimeve komunale).

Skema e Debitimit Direkt është lansuar në nëntor 2009 në tregun kosovar, për përdorim publik. I mundëson klientit të autorizojë bankën e tij, përmes kompanisë të debitojës (tërheqës) fonde direkt nga llogaria bankare. Ky instrument mundëson një mënyrë të standardizuar dhe automatizuar për pagesa të rregullta dhe të përsëritura.

Pagesat Kos Giro ofrojnë një mënyrë më efikase për të paguar faturat, si ato të cilat emetohen nga shoqëri të shërbimit publik, institucione qeveritare (Dogana, Agjencioni i Pasurive të Kosovës), etj.

Këto shërbime mund të anulohen ose modifikohen në çdo moment.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Banka Qendrore e
Republikës së Kosovës**

Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763



THE WORLD BANK

IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org

Telephone: +1 202 473-1000